

Më
Dana 12-12-2018

P.nr.1676/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PENAL-si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Hysnije Gashi si dhe me zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në lenden penale kundër të akuzuarit, [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Hani Elezit, për shkak të veprës penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1572-6/14 të datës 28.12.2015, në prani të Prokurorit të shtetit Avdullah Abedini të akuzuarit [REDAKTUAR] pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.23.01.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

[REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Hani Elezit” i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] i martuar baba i dy fëmijëve, me numër personal të letnjoftimit [REDAKTUAR] punon drejtor në shkollën “ [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] i gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 20.06.2014 rreth orës 16:30 në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, në parkingun e qendrës tregtare “Gama Center” duke drejtuar automjetin e markës “Audi 80”ngjyre të kuqe, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 42.1 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyre nuk ka qene i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit , ashtu që gjatë daljes nga parkingu, me pjesën e pare të anës së djathtë e ka goditur pjesën e pare të anës së majte veturën e markës “ Renault”Megane” ngjyre hiri, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilin e drejtonte [REDAKTUAR] e cila në atë momente ishte duke hyre në parking, pos dëmeve materiale në të dy njësit në këtë aksidente lëndime të lehta trupore pëson [REDAKTUAR] dhe atë: përdredhje të unazave të qafës me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

-me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4,7,17,21,49,50,51 të KPRK-së të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË NË LARTËSI PREJ 300 / treqindë / €

I pandehuri obligohet që dënimin e shqiptuar me gjobë ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen.49 par. 3 të KPRK-së , në të kundërtën do të zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20€ i pandehuri do të vuaj 1 (një) ditë burgu .

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj nuk ka parashtruar kërkesës pasurore-juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20/njëzet/€ si dhe shpenzimet e procedurës ne shumë prej 60.88/gjashtë dhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent /€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€(tritdhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 1572-6/14 të datës 28.dhjetor 2015, ndaj të akuzuarit: [REDAKTUAR] shkak të veprës penale rrezikim

trafikut publik nga nen 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datën 07.04.2016 në të cilin shqyrtim i akuzuari u deklarua i pafajshëm, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, andaj Prokurori i shteti Avdullah Abedini mbeti në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit duke i propozuar Gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor,

I akuzuari [REDAKTUAR], në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale rrezikim trafikut publik nga nen 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se data nuk i kujtohet por ka qenë viti 2014 duke drejtuar veturën e tipit "Audi" me ngjyre te kuqe, duke dalë nga parkingu ne ato momente kishte vërejtur automjetin e tipit "Renault" kishte frenuar po meqë koha ishte me shi nuk ka arritur te frenoj dhe e ka goditur automjetin Renault Regan në pjesën e përparme te anës se majtë .

3. Analiza e dëshmive, provave, dhe të gjeturat faktike të gjykatës.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit te tyre një nga një, dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën, vërtetoi gjendjen faktike:

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet i akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor; nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit e dt:06.02.2015, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë i dt:02.12.2015, nga dëshmia e dëshmitarit te dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga fotografit e vendit të ngjarjes në shkresat e lëndës.

4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Nga dëshmia e dëshmitarit - dëmtuarit, [REDAKTUAR] vërtetohet se ditën kritike ka qenë duke hyrë ne parkingun "Gama" me automjetin e markës "Renault Megan" në ato momente papritmas kishte ardhur automjeti "Audi" me ngjyrë te kuqe me një shpejtësi te madhe e kishte në pjesën e përparme te anës se majtë dhe pas goditjes i njëjti kishte ndier dhimbje të qafës ku kishte ndihmë mjekësore, nuk iu ka bashkangjitur ndjekjes penale , kërkesën pasurore juridike e ka realizuar përmes kopanisë së sigurimit.

Rrëfimi i këtij dëshmitari ka qenë i rëndësishëm përkitazi me rrethanën e vërtetimit të veprës penale që i përket të akuzuarit [REDAKTUAR] per faktin se edhe gjatë seancës së shqyrtimit është bërë ballafaqimi në mes të pandehurit dhe dëshmitarit, ku dëshmitari në mënyrë bindëse ia vërtetoi faktin se ditën kritike i akuzuari me automjet e tij "Audi" me shpejtësi deri sa i dëmtuari ishte duke hyre në ne parkingun "Gama Center" papritmas e ka goditur me pjesën e pare te anës se djathte të automjetit në pjesën e parë të anës së majtë veturën e tij "Renault Megane" në këtë aksident i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore.

Nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] konstatohet se i njëjti ditën kritike kishte qenë i ulur në ulësen e përparme te automjetit të të akuzuarit dhe deri sa ishin duke dalur nga parkingu ne momentin kur i akuzuari [REDAKTUAR] kishte frenuar e godet automjetin Renault" me pjesën e përparme dhe pas aksidentit janë ndalur dhe kanë biseduar me te dëmtuarin kanë dashur qe te mirën vesh mirëpo i dëmtuari nuk kishte pranuar.

Nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] konstatohet se ditën kritike pasi që e i akuzuari dhe e kishte thirre ne telefon dhe e kishte njoftuar per aksidentin, pastaj dëshmitari kishte shkuar tek vendi i ngjarjes dhe aty kishte vërejtur se aksidenti kishte ndodhur ne parkingun e qendrës" Gama" dhe kishte vërejtur se dy automjetet ishin te dëmtuara.

Dëshmisë se këtij dëshmitari gjykata ia fali besimin, mirëpo ky dëshmitarë ka vërtetuar faktin se ka ndodhur aksidenti pasi qe pas ndodhjes se aksidentit ka vizituar vendin dhe

drejtuar automjetin e markës "Audi 80" ngjyre te kuqe, me targa te regjistrimit [REDACTED] nga pakujdesia e ne kundërshtim me nenin 42.1 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, ne atë mënyre nuk ka qene i kujdesshëm gjate drejtimit te automjetit , ashtu qe gjate daljes nga parkingu, me pjesën e pare te anës se djathte e ka goditur pjesën e pare te anës se majte veturën e markës " Renault' Megane" ngjyre hiri, me targa te regjistrimit [REDACTED] te cilin e drejtonte [REDACTED] e cila ne atë momente ishte duke hyre ne parking, pos dëmeve materiale ne te dy njësit ne këtë aksidente lëndime te lehta trupore pëson [REDACTED] dhe atë: përdredhje te unazave te qafës me pasoja te përkohshme per shëndetin,-

8. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nenit 73 të KPK-së. Si rrethanë lehtësuese gjykata morri se i akuzuari nuk ka qen e dënuar me aktgjykim të formës së prerë. Ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë si dhe rrezikshmërinë e veprës penale, në kuptim të të gjitha këtyre rrethanave të akuzuarit i shqiptoj dënim si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se një dënim i tillë është proporcional me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit.

I dëmtuari [REDACTED] nga Ferizaj nuk ka parashtruar kërkesës pasurore-juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20/njëzet/€ si dhe shpenzimet e procedurës ne shumë prej 60.88/gjashtë dhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent /€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimin obligohet ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL


P.nr.1676/15 te datës 23.01.2018

Zyrtare ligjore:

Albana Ujupi

Gjyqtari:

Hysnije Gashi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.